

2020

RAPORT TREMUJOR I PUNËS- ZYRA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMUNA RAHOVEC

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Në kuadër të këtij tremujori, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të Punës për vitin 2020, i cili ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit. Ndërsa, bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Në muajin janar, angazhimet tona kryesisht kanë qenë në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit të gjashtëmujorit të dytë dhe raportin vjetor të NJAB-së për vitin 2019.
- Në muajin shkurt është bërë verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në vitin 2019.
- Raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2019 i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Si aktivitete të tjera mund të cekën edhe ofrimi i ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuara, ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Vlerësimi përmbyllës: Në këtë periudhë (janar-mars), NJAB-ja nuk ka arritur objektivat e planifikuara në bazë të Planit Vjetor, pasi që nuk ka arritur ti kryejë dy (2) auditime, për shkak të pandemisë nuk ka qenë e mundur të kryhet aktiviteti i auditimit të brendshëm në Drejtorinë për Punë Inspektuese.

Rahovec, 8 prill 2020